



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
**Fakulteti Ekonomik**

*(Master)*

*Ekonomiksi i personelit*

## **Syllabusi**

Prof.dr. Avdullah Hoti

*Viti akademik 2021-2022, Semestri dimëror*

# Informatat themelore për lëndën

<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti Ekonomik
<b>Titulli i lëndës:</b>	Ekonomiksi i Personelit
<b>Niveli:</b>	Master
<b>Statusi i lëndës:</b>	Zgjedhore
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti I, Semestri I
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+0
<b>Kreditë ECTS:</b>	4
<b>Koha / vendi:</b>	E hënë, ora 19:20-20:50, salla 4
<b>Mësimdhënësi:</b>	Prof. dr. Avdullah Hoti
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	Avdullah.Hoti@uni-pr.edu Orari i konsultimeve caktohet në ndërkohë

# Përshkrimi i lëndës

- Vendimet kryesore strategjike në kompani përfshijnë:
  - arritjen e numrit optimal të punëtorëve,
  - ngritjen e aftësive të punëtorëve për punë,
  - ndyrshimi i përbërjes arsimore apo të moshës së punëtorëve,
  - insentivat për motivimin,
  - forma dhe niveli i pagës etj.
- Trajtimi i temave përmes teorisë rigoroze të ekonomiksit
  - “Economic imperialism”
    - Kjo mundëson që edhe çështjet personelit të analizohen duke aplikuar teorinë dhe premiset e ekonomiksit si: maksimizimi i dobisë apo fitimit, insentivat dhe produktiviteti

# Qëllimet e lëndës

- ‘Ekonomiksi i Personelit’ ka për qëllim tu ofrojë studentëve:
  - (i) kornizën teorike për analizimin e çështjeve të resurseve humane/personelit në organizata biznesi dhe institucione të ndryshme dhe
  - (ii) disa aspekte të politikave që lidhen me menaxhimin dhe optimalizimin e përdorimit të resurseve humane/personelit.

# Rezultatet e pritura të nxënies

- Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jetë në gjendje që:
  1. Të analizojnë në mënyrë kritike anët pozitive dhe negative mbi qasjen ekonomike ndaj resurseve humane/personelit,
  2. Të përdorin modelet e ndryshme ekonomike për të analizuar situatat e ndryshme që paraqiten lidhur me resurset humane/personelin,
  3. Të vlerësojnë në mënyrë kritike efektin e politikave të ndryshme në sjelljen e resurseve humane/personelit në kuadër të organizatës.

# Ngarkesa e studentit

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>Ligjërata</b>	2	15	30
<b>Ushtrime/praktikë</b>			
<b>Testet</b>	2	2	4
<b>Zhvillimi i punimit seminarik</b>	4	4	16
<b>Punë e pavarur e studentit (në bibliotekë, shtëpi)</b>			97
<b>Testi Final</b>	3	1	3
<b>Totali</b>			150

# Metodat e mësimdhënies

- Kombinim i ligjëratave, diskutimeve dhe prezantimeve.
- 30 orë në kontakt me mësimdhënësin (15 javë x 2 orë).
- Orët e tjera të ngarkesës: studime të pavarura, përgatitje e seminareve, testeve dhe provimi përfundimtar.
- Tri javë ligjërata, çdo të katërtën javë organizohen seminare (diskutime) rreth një teme të caktuar.
- Studentët përgatisin seminarin për prezantim

# Metodat e vlerësimit

- Vlerësimi bëhet sipas njërit nga dy opcionet:
  - Opcioni 1:
    - Punim Seminarik 1            20 pikë
    - Testi 1                            40 pikë
    - Testi 2                            40 pikë
  - Opcioni 2
    - Provim me shkrim i rregullt        100 pikë
- Nota: deri në 49 pikë (5); 50-59 pikë (6); 60-61 pikë (7); 70-79 pikë (8); 80-89 pikë (9); 90-100 pikë (10)

# Literatura bazë

Edward Lazear and Michael Gibbs (2007):  
***Personnel Economics for Managers***, New York,  
Wiley.

# Literatura shtesë

1. Lazear, Edward (1998). *Personnel Economics for Managers*. Wiley & Sons, Inc., New York, NY
2. Lazear, Edward (1999). *Economic Imperialism*. Hoover Institution and Graduate School of Business, Stanford University
3. Lazear, Edward. *The future of personnel economics*; Economic Journal (2000): F611-F639.
4. Lazear, Edward, and Shaw, Kathryn. *Personnel economics: The economist's view of human resources*. Journal of Economic Perspectives, 21.4 (2007): 91-114.
5. Lazear, Edward and Oyer, Paul. *Personnel economics*. National Bureau of economic research, 13480. 2007.
6. Lazear, Edward (2011). *Inside the firm: contributions to personnel economics*. OUP Catalogue.
7. Artz, Benjamin (2010). *Fringe benefits and job satisfaction*. International Journal of Manpower, 31.6 (2010): 626-644.

# Plani i mësimit

Plani i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Kapitulli 1 – standardet e punësimit, cilësia e punës që punësohet
Java e dytë:	Kapitulli 2 – rekrutimi, resurset për rekrutim efektiv, shpallja
Java e tretë:	Kapitulli 3 – investimi në punëtorë, lidhja e tyre me firmën
Java e katërt:	Kapitulli 4 – qarkullimi i punëtorëve brenda dhe jashtë firmës
Java e pestë:	Kapitulli 5 – Krahasimi i kostove dhe përfitimeve nga vendimet
Java e gjashtë:	Kapitulli 6 – struktura organizative e firmës
Java e shtatë:	Kapitulli 7 – dizajnimi i vendit të punës
Java e tetë:	Kapitulli 8 – tema të avancuara lidhur me dizajnimin e punës
Java e nëntë:	Kapitulli 9 – vlerësimi i performancës së punëtorit
Java e dhjetë:	Kapitulli 10 – pagesa e performancës së punëtorit
Java e njëmbëdhjetë:	Kapitulli 11 – incentivat për karrierë
Java e dymbëdhjetë:	Kapitulli 12 – aksionet për punëtorë dhe pagesa për ekzekutivët
Java e trembëdhjetë:	Kapitulli 13 – Përfitimet e punëtorëve
Java e katërbëdhjetë:	Kapitulli 14 – ndërmarrësia në firma të reja dhe të matura
Java e pesëmbëdhjetë:	Kapitulli 15 – marrëdhëniet e punëtorit me firmën

# Politikat akademike

## Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Studentët inkurajohen të marrin pjesë në diskutime, të përgatisin seminare dhe të kryejnë studim të pavarur.
- Mësimdhënësi është në dispozicion për konsultime shtesë.
- Studentët kanë për obligim të lexojnë literaturën bazë dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që u jepen.
- Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit. Studentët inkurajohen të përcjellin diskutimet publike dhe të hapin diskutime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve lidhur me to.
- Studentët duhet të respektojnë institucionin dhe rregullat akademike, orarin e ligjëratave dhe të jenë të angazhuar gjatë zhvillimit të orës mësimore.
- Është e obligueshme posedimi i ID-së në teste dhe provim.
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studentët duhet tu përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi lidhur me rregullat e shkrimit akademik.